



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

RAPORTI VJETOR 2015



Tabela e lëndës:

Parathënie – Mesazh nga Kryetari	4
Organizimi i AAB	7
Sistemi Bankar Shqiptar në 2015 – Treguesit kryesorë	10
Ndryshimet legjislative dhe rregullatore	12
Aktivitetet e AAB	15
■ Komitetet teknike	16
■ Takime të tjera	19
■ Edukimi financiar	22
■ Forume, seminare dhe trajnime	25
■ Botime	31
Bankat anëtare – Shifra dhe Fakte	32
Pasqyrat financiare të AAB-së për 2015	34

Parathënie nga Kryetari

I dashur lexues,

Gjatë vitit 2015 ekonomia shqiptare shfaqti performancën më të mirë që nga viti 2011. Vlerësimet e para për vitin 2015 tregojnë një rritje prej 2.61%, e cila, edhe pse më e lartë se vitet e fundit, është ende nën potencialin e vendit. Rritja është nxitur kryesisht nga sektorët e ndërtimit, shërbimeve dhe eksportet. Në vitin 2015, totali i aktiveve të sistemit bankar ka vazhduar të rritet në bazë vjetore, por me një ritëm më të ulët, prej vetëm 1.9% krahasuar me 4.8% në vitin 2014. Arsyet kryesore për rritjen e dobët të aktiveve të sistemit ishin mundësitë e kufizuara për investime, pasi kërkesa për financime cilësore mbeti e dobët si dhe rënia e menjëhershme e normave të letrave me vlerë të qeverisë.

Sektorit bankar, pavarësisht trazirave rajonale, ka arritur të jetë likuid dhe i mirëkapitalizuar. Ashtu siç pritej, kriza greke nuk ka ndikuar në depozitat gjithsej në vend, ndërsa depozitat gjithsej u rritën me 2.6% në bazë vjetore duke arritur nivelin prej 8 miliardë euro në dhjetor 2015, çka konfirmon besimin e konsumatorëve të sistemi bankar shqiptar. Kredia në sistemin bankar mbeti pothuajse në të njëjtin nivel prej 4,268 miliardë euro në dhjetor 2015 krahasuar me 4,247 miliardë euro në dhjetor 2014. Megjithatë, ky nivel nuk duhet të keqorientojë; nëse përjashtohet efekti i forcimit të lekut ndaj euros, atëherë kredia gjithsej do të tkurrej me 1.5% në vitin 2015. Kërkesa e dobët, kryesisht nga segmenti i ndërmarrjeve të vogla dhe korporatave, është arsyeja kryesore e performancës së dobët.

Një zhvillim i rëndësishëm pozitiv në sektorin bankar gjatë vitit 2015 ishte përmirësimi i vazhdueshëm i nivelit të kredive me probleme, duke rënë në 18.2% të kredive gjithsej deri në fund të dhjetorit 2015, çka tregon se masat e reja nga Banka e Shqipërisë po japin rezultat. Ky është një lajm i shkëlqyer. Niveli aktual i kredive me probleme nuk kishte rënë në këtë nivel që nga viti 2011. Shoqata Shqiptare e Bankave pret që ekonomia të përshpejtohet me rreth 3.4% me mbështetjen e investimeve të huaja direkte, eksporteve, politikën e lehtësuar monetare dhe efektet pozitive të reformave strukturore. Aktiviteti kreditues pritet të përmirësohet gjatë vitit 2016 falë rritjes ekonomike dhe masave nxitëse të politikës monetare, të cilat, mbështetur edhe nga reforma shumë e nevojshme në sistemin gjyqësor, do të rrisin besimin e sektorit privat. Shoqata do të vazhdojë të luajë një rol kyç në çuarjen përpara të interesave të bankave anëtare të saj, duke dhënë kontributin e saj për konsolidimin e kuadrit rregullator dhe klimës së investimeve në përgjithësi.



Christian CANACARIS
Kryetar





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



BORDI DREJTUES

I SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE



Z. Christian CANACARIS
KRYETAR
Drejtore i Përgjithshëm,
RAIFFEISEN BANK SHQIPËRI



Z. Gazmend KADRIU
ZËVENDËS KRYETAR
Drejtore i Përgjithshëm,
UNION BANK



Z. Frédéric BLANC
ANËTAR
Drejtore i Përgjithshëm,
SOCIETE GENERALE ALBANIA



Z. Periklis DROUGKAS
ANËTAR
Drejtore i Përgjithshëm,
ALPHA BANK ALBANIA



Z. Seyhan PENCAPLIGIL
ANËTAR
Drejtore i Përgjithshëm,
BANKA KOMBËTARE
TREGTARE



Z. Bozhidar TODOROV
ANËTAR
Drejtore i Përgjithshëm,
FIBANK SHQIPËRI

SEKRETARIATI



Endrita XHAJFERAJ
Sekretare e Përgjithshme
(DERI NË PRILL 2016)




Brunilda KOSTARE
Këshilltare Ligjore



Junida TAJFAJ
Oficere e Operacioneve



Eftali PEÇI
Specialiste e Komunikimit



Marsela BULKU
Asistente Administrative

KOMITETET TEKNIKE

- 1 Komiteti i Auditorëve të Brendshëm
- 2 Komiteti i Burimeve Njerëzore
- 3 Komiteti i Kartave
- 4 Komiteti i Komunikimit
- 5 Komiteti i Përputhshmërisë
- 6 Komiteti i Sigurisë Bankare
- 7 Komiteti i Sigurisë së Informacionit
- 8 Komiteti i Sistemeve të Pagesave
- 9 Komiteti i Thesarit dhe Tregjeve
Financiare
- 10 Komiteti Ligjor

ANËTARËSIMET

AAB është anëtare me të drejta të plota, anëtare e asociuar apo partnere e organizatave ndërkombëtare /kombëtare, si më poshtë:

Anëtarësimet ndërkombëtare

- Federata Evropiane e Bankave (FEB)
- Forumi Ndër - Ballkanik i Shoqatave të Bankave
- Shoqatave e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE)
- OECD Rrjeti Ndërkombëtar për Edukimin Financiar (INFE)
- Shoqata e Evropiane e Trajnimeve Bankare & Shërbime Financiare (EBTN)
- Agjencia e Transfertave për Teknologjinë Financiare

Anëtarësimet kombëtare

- Këshilli Ekonomik Kombëtar
- Këshilli Tatimor
- ICC Albania – Komiteti Kombëtar i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC)
- Këshilli Kombëtar i Punës
- Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA)



SISTEMI BANKAR SHQIPTAR 2015

PAMJE E PËRGJITHSHME MBI SEKTORIN

16

BANKA ME KAPITAL
TË GJITHIN PRIVAT

13 BANKA ME KAPITAL
PRIVAT TËRËSISHT TË HUAJ

3 BANKA ME KAPITAL PRIVAT
TË HUAJ DHE VENDAS

BILANCI NË TOTAL:

1,318 miliardë Lekë 91.3% e GDP
+ 1.9%

RRITJE NGA 2014

TOTALI I DEPOZITAVE:

1,100 miliardë Lekë 71.8% e GDP
+ 3.3%

RRITJE NGA 2014

KAPITALI I AKSIONARËVE:

125.528 miliardë Lekë +13.1% RRITJE NGA 2014

RAPORTI I LIKUIDITETIT:

41.4%

RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË
SË KAPITALIT:

16.04%

RAPORTI I KREDIVE ME PROBLEME NDAJ KREDISË GJITHSEJ:

18.2%

4.6 PIKË PËRQINDJE MË PAK SE 2014

TREGUESIT KRYESORË

	2014 (%)	2015 (%)
ROA	0.89	1.2
ROE	10.53	13.16



SIGURIMI I NJË INFRASTRUKTURE FINANCIARE MODERNE DHE EFIKASE:

AGJENCI DHE DEGË TË BANKAVE:

500

PIKA TËRHEQJE PARASH (ATM):

826

15 ATM TË REJA U SHTUAN GJATË VITIT

PIKA SHITJEJE NË DYQANE DHE BIZNESE (POS):

6,689

149 SHTUAR GJATË VITIT

KARTA DEBITI DHE KREDITI TË LËSHUARA:

936,177

8.6% MË SHUMË SE 2014

TRANSAKSIONE ME KARTA:

VOLUMI: 15,080,593

VLERA: 184.5 miliardë Lekë

RRITJA E VLERËS NGA TRANSAKSIONET ME KARTA NGA 2014

36%

TRANSAKSIONE BANKARE PËRMES INTERNETIT:

VOLUMI 1,404,052


12% MË SHUMË SE 2014

VLERA: 282.8 MILIARDË LEKË

72% MË SHUMË SE 2014

NDRYSHIMET NË KUADRIN RREGULLATOR PËR BANKAT

Mjedisi rregullator në të cilin veprojnë bankat në Shqipëri, vazhdon të evoluojë, me fokus të veçantë në përafrimin dhe konvergimin me rregulloret dhe praktikatat më të mira evropiane. Seksioni më poshtë pasqyron një përmbledhje të ligjeve, akteve nënligjore dhe rregulloreve kryesore të ndryshuara apo të miratuara rishtazi nga autoritetet përkatëse gjatë vitit 2015, të cilat kanë dhënë efekte në aktivitetin bankar në Shqipëri.



REGULLORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Prill - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me Vendimin Nr. 25, datë 01.04.2015 ndryshoi Rregulloren “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”. Ndryshimet synojnë të rrisin transparencën dhe të nxisin disiplinën në të gjithë sektorin bankar, si edhe të sigurojnë qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e këtij sektori.

Korrik - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim propozimet e bankave nëpërmjet Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe miratoi në mbledhjen e tij të datës 1 korrik 2015 ndryshimet në Rre-

gulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” dhe “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave” sipas të cilave investimet e bankave në sigurimet e borxhit të qeverisë shqiptare në monedhë të huaj mund të ponderohen me 50 për qind të rrezikut (në vend të 100), ndërsa në përlllogaritjen e ekspozimit të lejuar ndaj qeverisë shqiptare për investimet në sigurimet në monedhë të huaj bankat përfitojnë një zbritje prej 50 për qind. Masat e reja do të jenë në fuqi për një periudhë 5 vjeçare.

Korrik - Me Vendimin Nr. 48, datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

miratoi Rregulloren e re “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare.” Rregullorja e re synon të parashtrojë standardet lidhur me përmbajtjen dhe mënyrën e ofritit të informacionit parakontraktual dhe kontraktual për kreditë konsumatore dhe kreditë hipotekare për klientët dhe konsumatorët, si dhe masat për dhënien e kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare.

Gusht - Në vijim të procesit të shqyrtimit të kuadrit rregullator për qarkullimin e bankënotave dhe monedhave, kryesisht me synimin për të fuqizuar dhe zbatuar ndryshimet e ligjit “Për Bankën e Shqipërisë,” kjo e fundit miratoi draft Rregulloren Nr. 56 “Për veprimet me fondet në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë.” Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurat e transaksioneve në cash në Bankën e Shqipërisë.

Shtator - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi Rregulloren Nr. 67 “Për sistemin e kontrollit të brendshëm në bankat dhe degët e bankave të huaja,” të cilat ndryshojnë të gjithë kuadrin e rregullave për organizimin, funksionimin dhe strukturat përgjegjëse për sistemet e kontrollit të brendshëm në banka dhe në degët e bankave të huaja në Shqipëri.

Nëntor - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi Rregulloren e re Nr. 82 “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve të pagesave dhe shtëpive të klerimit të pagesave.” Ajo synon të garantojë sigurinë, stabilitetin dhe gjendjen e shëndoshë dhe eficiencën e operatorëve të sistemeve të pagesave dhe shtëpive të klerimit të pagesave, duke përcaktuar kriteret dhe parimet për subjektet licencuese dhe ato mbikëqyrëse të cilat kërkojnë të kryejnë aktivitete në këtë fushë.



LIGJE DHE AKTE NËNLIGJORE TË TJERA

Ndryshimet në Kodin e Punës

Në datën 05.12.2015 Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 136/2015 "Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" me ndryshime. Ndër të tjera, ndryshimet kryesore përqendrohen në: punësimin e përkohshëm të qytetarëve të huaj; punësimin me kohë të pjesshme; prezantimin e "agjencisë së punësimit të përkohshëm" si një koncept i ri në kod; lejen vjetore dhe leje të tjera; orarin e punës dhe punën në fundjavë, ose në ditë pushimi zyrtar si dhe punën përtej orarit zyrtar.

Ligji i Ri "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"

Në datën 26.11.2015 Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit." Ligji synon të lehtësojë më tej zhvillimin e biznesit në Shqipëri duke ofruar realizimin e procedurave të regjistrimit dhe licencimit në një institucion të vetëm që do të jetë Qendra Kombëtare e Biznesit. Me krijimin e Qendrës Kombëtare të Biznesit, Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Qendra Kombëtare e Licencimit do të pushojnë së ekzistuari.

Ndryshimet "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"

Në 23.9.2015 Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 99/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 'Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.'" Ligji përmban një sërë ndryshimesh me interes për taksapaguesit, regjistrimin e tyre dhe ndëshkimet përkatëse në rast të shkeljes së legjislacionit të taksave duke synuar forcimin e masave kundër ekonomisë informale.

Ligji Nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë"

Më 28.5.2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 55/2015 "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë", si pjesë e iniciativës për lehtësimin dhe përmirësimin e investimeve strategjike të huaja dhe vendase. Ligji i ri ka për qëllim të sigurojë stimuj për tërheqjen e investimeve strategjike të huaja dhe vendase në sektorët e identifikuar në ligj si strategjik, duke krijuar përfitime të veçanta në lehtësimin apo përsheptimin e procedurave administrative, për të mbështetur dhe për t'u shërbyer investitorëve.

Ndryshimet në ligjin Nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik"

Më 23.09.2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 101/2015 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik". Ndryshimet në ligj synojnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të sektorit publik dhe futjen e teknologjive inovative në raport me dokumentet në letër.

Ligji i ri Nr. 107/2015 "Për Identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara"

Më 01.10.2015 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara". Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin ligjor për identifikimin elektronik, vulën elektronike, ofrimin e shërbimit elektronik dhe çertifikimin e siteve të internetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe të rrisë besimin në transaksionet elektronike në tregun e brendshëm, duke siguruar një bazë të përbashkët për një ndërveprim të sigurt elektronik ndërmjet qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve publike.

AKTIVITETET E AAB



KOMITETET TEKNIKE & TAKIME TË TJERA

Seksioni më poshtë përmbledh aktivitetet kryesore të zhvilluara nga 10 komitetet e përhershme të Shoqatës së Bankave të Shqipërisë përgjatë vitit 2015. Komitetet Teknike të AAB-së dhe grupet e punës të ngritura prej tyre zhvilluan më shumë se 55 mbledhje gjatë vitit 2015, për të diskutuar dhe ndarë së bashku përvojat dhe shqetësimet lidhur me çështjet legjislative dhe ato të aktivitetit të përditshëm. Këto çështje janë ndjekur në praktikë nga Sekretariati i AAB-së gjatë gjithë vitit në shqyrtim.

Komiteti i Kartave

Në 3 mbledhjet e organizuara gjatë gjithë vitit, anëtarët e Komitetit të Kartave diskutuan çështje me interes të përbashkët, si bashkëpunimi me tregtarët; tendencat e mashtrimit me kartat dhe masat që duhen ndërmarrë nga bankat; fillimin e një fushate të orientuar nga klientët për të shtuar transaksionet me anë të kartave dhe nevojën për trajnimin e stafit të bankave.

Lidhur me trajnimet, Komiteti mbështeti Sekretariatit e AAB-së në diskutimet e këtij të fundit me Shkollën e Biznesit VISA (VISA Business School) dhe Akademinë Master Card (Master Card Academy) për mundësinë e organizimit të trajnimeve sipas kërkesave të

posaçme për bankat shqiptare në Tiranë. Ky bashkëpunim i suksesshëm rezultoi me një trajnim të strukturuar posaçërisht për mjedisin shqiptar lidhur me çështjet e mashtrimit me kartat. Ky trajnim u zhvillua në Tiranë në bashkëpunim me VISA Business School në tetor 2015.

Nisur nga situata në të cilën ekziston një mungesë informacioni për transaksionet me karta në raportet ekzistuese të Bankës së Shqipërisë, Komiteti mbështeti Sekretariatit në përgatitjen e një formati raportimi mbi pagesat me karta, i cili u dërgohet bankave çdo tremujor si pjesë përbërëse e raportit përfundimtar për sektorin bankar në Shqipëri.

Komiteti për Sigurinë Bankare

Temat më të diskutuara në 5 mbledhjet e Komitetit për Sigurinë Bankare gjatë vitit 2015 ishin ato që kishin të bënin me zbatimin e rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për kërkesat minimale të sigurisë në mjediset në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare,” si dhe problemet e sigurisë në transportimin e vlerave monetare të bankave nga shoqëritë private të sigurimit.

Dy përfaqësues të Kryesisë së Komitetit ishin anëtarë të grupit të punës të krijuar nga Banka e Shqipërisë (me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme)

që shqyrtoi rregulloren e sipërpërmendur me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve në ligjin e ri të miratuar “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.

Shërbimet e këtyre shoqërive private ishin themeli i diskutimeve mbi transportin e vlerave monetare, për të cilin nevojitet një përcaktim më i mirë i standardeve si në aspektin e mjeteve të transportit që përdorin këto shoqëri, ashtu edhe në aspektin e cilësisë së përgatitjes dhe numrit të anëtarëve të eskortave. Anëtarët e Komitetit u takuan me përfaqësuesit e Shoqërive private të sigurimit

me që-llim përmirësimin e bashkëpunimit dhe gjetjen e zgjidhjeve drejt standardeve më të mira të shërbimit. Problemet me të cilat përballen bankat në sferën e transportit të vlerave monetare brenda aeroportit, qenë, gjithashtu, objekt diskutimi gjatë vitit 2015. Këto probleme

u trajtuan edhe në një takim midis përfaqësuesve të Komitetit dhe drejtuesve të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

Në qershor, Komiteti zgjodhi kryesinë e re dhe z. Roland Tashi nga Tirana Bank u rizgjodh Kryetar i Komitetit.

Komiteti i Auditorëve të Brendshëm të Bankave

Në 2 mbledhjet e zhvilluara gjatë vitit, Komiteti i Auditit të Brendshëm ndoqi ecurinë e çështjeve tashmë të diskutuara dhe të trajtuara bashkërisht me Bankën e Shqipërisë gjatë vitit 2014 mbi nevojën e rishikimit të rregulloreve rreth kontrollit të brendshëm të bankave, veçanërisht sa i takon planifikimit dhe shpeshësisë së kontrolleve të plota të brendshme. Në këtë kontekst, anëtarët e Komitetit mbështetën Sekretariatit e AAB-së në mbledhjen e çështjeve me interes për t'iu paraqitur Bankës së Shqipërisë, e cila mori në konsideratë pjesën më të madhe të sugjeri-

meve në projekt rregulloren e re të paraqitur rishtazi. Komiteti u mbledh dy herë në korrik për të diskutuar mbi ndryshimet e propozuara dhe njëra nga mbledhjet u bë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Bankës së Shqipërisë. Rregullorja përfundimtare u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në shtator 2015.

Përveç kësaj, Komiteti mbështeti Sekretariatit e AAB-së dhe Institutin Shqiptar të Auditorëve të Brendshëm (AIIA) në organizimin për herë të parë në Tiranë të një Forumi të Auditorëve të Brendshëm në qershor 2015.

Komiteti i Përputhshmërisë

Komiteti i Përputhshmërisë zhvilloi 5 mbledhje gjatë vitit 2015 për të diskutuar mbi çështje të tilla, si ndryshimet e fundit në Rregulloren "Mbi Veprimtarinë Valutore" që kanë të bëjnë me vështirësitë në dokumentacionet që duhen paraqitur nga klientët për kryerjen e transferave ndërkombëtare; shqetësimet e krijuara nga urdhrat e bllokimit që kanë qenë të shpeshtë dhe të shumtë si nga institucionet shtetërore qendrore, ashtu edhe ato lokale; nevoja për trajnimin e anëtarëve të Komitetit dhe të stafit në degët e bankave, etj., që ka pasur ndikim në veprimet operacionale të bankave gjatë vitit 2015. Një tjetër çështje e diskutuar midis Komitetit dhe Ministrisë së Financave ishte ajo e një Sistemi të Përbashkët Raportimi në të gjithë vendin, me qëllim sigurimin e raportimit në përputhje me atë të autoriteteve të taksave të vendeve europiane.

Anëtarët e Komitetit, gjithashtu, trajtuan edhe kërkesat dhe gjetjet më të fundit të inspektimeve të kryera nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe identifikimin e masave të unifikuara për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Në dy nga mbledhjet e Komitetit gjatë vitit 2015 mori pjesë edhe Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, i cili theksoi nevojën dhe vlerën e shtuar të përpjekjeve të bankave në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel vendi. Në këto mbledhje, u theksua edhe nevoja për bashkëpunimin e bankave në luftën e qeverisë kundër korrupsionit.

Në prill 2015, Komiteti zhvilloi zgjedhjet për kryesinë e re. Këto zgjedhje rezultuan me zgjedhjen e z. Andin Jakova nga ICB si kryetar

i ri i Komitetit. Si anëtarë të rinj të kryesisë së Komitetit, u zgjodhën zj. Doriana Larti nga So-

ciete Generale Albania, z. Ndue Maluta nga BKT dhe zj. Suela Dhima nga Tirana Bank.

Komiteti për Burimet Njerëzore

Komiteti për Burimet Njerëzore zhvilloi 2 mbledhje gjatë vitit 2015 si dhe komunikime të shpeshta e takime në grupe të vogla. Anëtarët e Komitetit vazhduan të raportojnë në baza gjashtëmujore të dhënat për raportin e indikatorëve kyç të performancës së burimeve njerëzore, i cili përpunohet nga BKT me ndihmën e AAB-së. Ky raport ka rezultuar një mjet i rëndësishëm për politikën e brendshme të secilës bankë dhe përfshin tregues që kanë të bëjnë me: organizimin dhe strukturën e fuqisë punëtore; përfshirjen e kapitalit njerëzor; trajnimet dhe zhvillimin; ndikimin e kapitalit njerëzor, kujdesin shëndetësor; rezultatet financiare, etj.

Komiteti është mbështetësi dhe kontribuesi

kryesor në trajnimet e organizuara nga AAB për punonjësit e bankave gjatë vitit 2015, proces ky që është në përmirësim të vazhdueshëm.

Gjatë vitit në fjalë, anëtarët e Komitetit kanë bashkëpunuar me palë të treta, si universitetet dhe Programi i Arritjeve Rinore në Shqipëri për realizimin e praktikave në banka, si dhe për kontributin e profesionistëve në banka si vullnetarë në procesin e mësimdhënies. Gjithashtu, Komiteti ka dhënë komente dhe opinione për rishikimin e akteve nën-ligjore të caktuara, si për shembull, “Lista Kombëtare e Profesioneve” paraqitur nga Agjencia Kombëtare për Arsimin, Trajnimin Profesional dhe Kualifikimet.

Komiteti për Sigurinë e Informacionit

Komiteti për Sigurinë e Informacionit mbajti 3 takime gjatë vitit 2015, në të cilat anëtarët diskutuan rreth shqetësimeve të përbashkëta lidhur me kërcënimet ndaj sigurisë së informacionit dhe masave të mundshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga këto kërcënime. Kryesia dhe anëtarët e Komitetit mbështetën Sekretariatit e AAB-së për organizimin e disa prezantimeve të rëndësishme, si taktikat e përparuara në metodat që përdorin hakerat, përmirësimi i efikasitetit dhe produktivitetit përmes shërbimeve arkivuese, siguria e aplikacioneve lëvizëse – me studime rastesh të vërteta, etj. Komiteti organizoi Fo-

rumin e Katërt të Përvitshëm të Sigurisë (në bashkëpunim me Sekretariatit e AAB-së, Komitetin e Sigurisë Bankare dhe Shoqatën e Bankave të Kosovës), i cili trajtoi problemet e sigurisë fizike, sigurisë së informacionit dhe mashtrimeve në sistemin bankar.

Një nga mbledhjet e Komitetit iu kushtua tërësisht diskutimit dhe përgatitjeve të komenteve të përbashkëta të sektorit bankar me rastin e përgatitjes së projekt ligjit të ri për sigurinë kibernetike paraqitur nga Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

Ky ligj synon krijimin e një kuadri rregullator të qëndrueshëm në këtë fushë.

Komiteti Ligjor

Komiteti Ligjor u mbledh shumë shpesh gjatë vitit për të reflektuar rreth çështjeve të shumta me natyrë ligjore me të cilat janë përballur bankat në shumë aspekte të veprimtarisë së tyre. Çështjet kryesore të diskutimeve në 11 mbledhjet, të cilat u ndoqën në vijimësi nga Komiteti, ishin:

Rasti i një gjyqtari në Fier, i cili pezulloi tre raste për ekzekutimin e kolateralit nga bankat dhe paraqiti kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese për abrogimin e ndryshimeve të bëra në vitin 2013 në Kodin e Procedurës Civile. Komiteti e këshilloi AAB-në lidhur me detyrimin dhe të drejtën e saj për t'u përfshirë në këtë rast gjatë procesit të shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese përmes një studioje ligjore. Kërkesa e AAB-së u miratua nga Gjykata Kushtetuese dhe Studio Ligjore që përfaqësonte AAB-në e fitoi gjyqin dhe ndryshimet e bëra në Kod me nismën e bankave vazhdojnë të jenë në fuqi.

Anëtarët e Komitetit diskutuan mes tyre dhe me përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë rreth disa procedurave abuzive nga përmbauesit privatë të cilët kërkonin të bllokoni dhe ekzekutoni llogaritë e palëve të treta, duke synuar një qasje të unifikuar nga të gjitha bankat. Në këtë kontekst, Komiteti diskutoi, gjithashtu, rreth Udhëzimit të lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Përmbarrimit për të unifikuar procedurat e të gjithë përmbauesve privatë për mosnjohjen e interesave të përlogaritura nga bankat pas daljes së urdhrimit të ekzekutimit, çka u gjykua si një tejkalim i kompetencave të Dhomës së Përmbarrimit.

Komiteti mbështeti Sekretariatit e AAB-së për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë lidhur me shqetësimin e bankave rreth praktikave të gjykatave që kërkojnë të bëhet rivlerësimi apo pranojnë pretendimet për rivlerësimin e kolateralit dhe që nuk njohin si detyrim të huamarësit interesin e akumuluar të përlogaritur nga

bankat pas daljes së urdhrimit të ekzekutimit.

Komiteti diskutoi me anëtarët e Komitetit Ekzekutiv dhe më pas qarkulloi idetë rreth një propozimi nga AAB për ndryshime të mundshme në Kodin e Procedurës Civile dhe nisma të tjera ligjore për pakësimin apo eliminimin e kredive me probleme. Propozimet përfundimtare iu dërguan Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave dhe autoriteteve të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Propozimet përfshinin ndryshime të nevojshme në Kodin e Procedurës Civile, Kodin Civil, Ligjin "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme," Ligjin "Për barrët siguruuese" dhe Ligjin "Për procedurat tatimore."

Komiteti u mbledh dy herë për të diskutuar draft ligjin "Për falimentimin" dhe për t'i paraqitur komente grupit të punës dhe Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë kontekst, anëtarët e Komitetit paraqitën qëndrimin e bankave në tavolinën e rrumbullakët organizuar nga IFC dhe Ministria e Drejtësisë më 28 gusht 2015, ku u diskutua projekt-Ligji për Falimentimin me të gjitha grupet e interesit.

Komiteti u mbledh në shtator për të diskutuar dhe përgatitur një opinion që do t'i paraqitej Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, lidhur me qëndrimin e kësaj të fundit për bankat që pranojnë bilance të paudituar kur japin kredi. Lidhur me këtë, Autoriteti sqaroi se, ndërsa bankat veprojnë sipas rregullave dhe rregulloreve të nxjerra nga Banka e Shqipërisë në aktivitetin e tyre kredidhënës, ato duhet të jenë të vetëdijshme për tipologjitë që mund të kenë lidhje ne evazionin e taksave dhe duhet të marrin masa për t'i parandaluar ato.

Gjatë muajit tetor, Komiteti iu kthye shqetësimeve që u dalin bankave me ekzekutimin e shumave në llogaritë e palëve të treta sipas urdhrave të përmbarrimit. Në këtë kuadër, AAB iu drejtua bankës së Shqipërisë me kërkesën

për ndryshime në Udhëzuesin e lëshuar prej saj “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë”, e cila u pasua nga një takim i Komitetit me përfaqësues të Departamentit Ligjor të Bankës së Shqipërisë, në të cilin u arrit një marrëveshje për ndryshimet që do të bëheshin.

Një tjetër çështje me interes gjatë gjithë vitit ishin ndryshimet e nevojshme në ligjin “Për Barrët Siguruese”, i cili, pas ndryshimeve të vitit 2013, paraqiste vështirësi operacionale për bankat. Këto vështirësi u ishin paraqitur në mënyrë të përsëritur gjatë viteve të fun-

dit Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë. Anëtarët e Komitetit e ndoqën çështjen dhe në dhjetor 2015 u zhvillua një takim teknik me përfaqësuesit e Departamentit Ligjor të Ministrisë së Ekonomisë.

Në takimin e organizuar në dhjetor, Komiteti zhvilloi zgjedhjet dhe miratoi rregulloren e ndryshuar për funksionimin e Komitetit. Kryetare e Komitetit u rizgjodh znj. Veronika Prifti nga BKT. Si anëtarë të Kryesisë u zgjodhën znj. Ledia Plaku, nga Banka Intesa Sanpaolo Albania dhe znj. Albina Hasanaj nga Societe Generale Albania.

Komiteti i Marrëdhënieve me Publikun dhe Komunikimin

Komiteti për Marrëdhëniet me Publikun dhe Komunikimin u krijua me vendim të Bordit Drejtues të AAB-së në Janar 2015 dhe organizoi 3 mbledhje gjatë vitit.

Qëllimi i Komitetit është të mbështesë dhe të ofrojë këshilla për Sekretariatit e AAB për një komunikim efikas me mediat dhe me publikun për konsolidimin e imazhit dhe reputacionit të sektorit bankar në Shqipëri, veçanërisht në periudha sfidash të mëdha për industrinë bankare.

Komiteti dha kontributin e tij për hartimin e një Plani Komunikimi (për Menaxhimin e Krizave) për AAB-në, i cili u miratua nga anëtarët e Komitetit Ekzekutiv. Gjatë gushtit kryesia e

Komitetit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Komunikimin ndihmoi Sekretariatit në aktivitetet e organizuara me mediat (më shumë informacion do të gjeni në seksionin “Veprimtari Shoqërore” të këtij raporti).

Pas paraqitjes nga Dhoma Ndërko-mbëtare e Tregëtisë në Shqipëri së Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm që shtetet anëtare të OKB do t’i përdorin për të formësuar politikat e tyre në 15 vitet e ardhshme për promovimin e paqes, begatisë dhe mbrojtjes së mjedisit, anëtarët e Komitetit ranë dakord të ndiqnin në vijim punën e bankave në mbështetje të zbatimit të Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Komiteti i Sistemeve të Pagesave

Komiteti i Sistemeve të Pagesave u mbledh në 2 takime gjatë vitit 2015. U organizua edhe 1 takim i grupit të punës krijuar brenda Komitetit për diskutimin e çështjeve lidhur me zbatimin e ndryshimeve në rregulloren “Për veprimtarinë valutore.” Lidhur me këtë temë, grupi i punës u takua me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë për të sqaruar çështjet dhe komentet e mbetura pezull, çka u përmbyll me

një letër shpjeguese që Banka e Shqipërisë u dërgoi të gjitha bankave.

Anëtarët e Komitetit diskutuan, gjithashtu, edhe mbi projekt ligjin e ri “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve të pagesave dhe shtëpive të klerimit të pagesave,” paraqitur nga Banka e Shqipërisë në shtator 2015. Sekretariati i AAB-së mbledhi komentet dhe pyetjet e bankave për sqarime

të mëtejshme të përkufizimeve, të cilat më vonë ia dërgoi Bankës së Shqipërisë. Më pas ato u përpunuan nga përfaqësuesit e kësaj të fundit që kishin marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit në nëntor.

Çështje të tjera të diskutuara nga anëtarët e Komitetit gjatë vitit ishin: mundësia e unifikimit të qasjes së bankave lidhur me komisionet hetimore për urdhrat e transfertave dhe

plani i veprimit i dakordësuar me Komitetin Kombëtar të Pagesave në takimin e tij të parë për përmirësimin e sistemeve të pagesave, përfshirë unifikimin e formularëve të urdhrave të transfertave në përdorim nga bankat; zhvillimin e sistemit ndërbankar të debitimit direkt; e shlyerjes së transfertave në monedhë të huaj brenda vendit, etj.

Komiteti i Thesarit dhe Tregjeve Financiare

Komiteti i Thesarit dhe Tregjeve Financiare bëri 3 mbledhje gjatë vitit, një nga të cilat e kërkuar posaçërisht nga Banka e Shqipërisë për të diskutuar pyetësonin e ri të hartuar nga Departamenti i Politikës së Thesarit dhe ai i Kërkimit me qëllim përmirësimin e procesit analitik dhe kërkimor të performancës së treguesve financiarë në Shqipëri.

Anëtarët e Komitetit diskutuan gjatë vitit mbi nevojën e një marrëveshjeje të unifikuar/

të përbashkët për tregtimin e instrumenteve derivate (Forwards dhe Swaps) ndërmjet bankave në Shqipëri. Gjatë shqyrtimit të përvojave të bankave mëmë të vendosura në Evropë, brenda Komitetit u ngrit një grup pune, i cili hartoi një version të parë të marrëveshjes që do të rishikohet nga të gjithë anëtarët e Komitetit, si dhe nga Komiteti Ligjor, përpara se të jetë gati për t'u nënshkruar (jo detyrimisht) nga bankat.

TAKIME TË TJERA TEKNIKE

Me Bankën e Shqipërisë

Gjatë vitit pati takime të shpeshta me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe Komiteteve Teknike të AAB-së apo grupeve të tjera ad-hoc për të diskutuar rreth nismave të shumta rregullatore për ndryshime në rregulloret ekzistuese apo të reja, si: rregullorja e re “Për kredinë konsumatore dhe hipotekare për individët”, Rregullorja “Për administrimin e rrezikut të kredisë në veprimtarinë e bankave dhe degëve të bankave të huaja”, Rregullorja “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve të pagesave dhe shtëpive të klerimit të pagesave”.

Përveç këtyre, pati edhe takime dhe diskutime lidhur me nisma të tjera:

Me kërkesën e AAB-së, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një nismë për krijimin e një Indeks Çmimesh për Pasuritë e Paluajtshme në

Shqipëri. Për këtë qëllim, në mars u zhvillua një takim në mjediset e AAB midis përfaqësuesve të departamenteve të riskut dhe përpunimit të kredisë në banka dhe Bankës së Shqipërisë për të diskutuar rreth një pyetësoni që do të shërbente për raportim nga bankat. Pjesëmarrësit në takim finalizuan një pyetësoni i cili përfshin informacion rreth banesave të vendosura në hipotekë si garanci për kredi të reja bankare, i cili duhet plotësuar një herë në tre muaj. Ndërkohë bankat u angazhuan të japin informacion për pesë vitet e fundit sipas formatit që çdo bankë ka në sistemin e vet.

Në kuadrin e zhvillimeve të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë lidhur me zgjerimin e informacionit që aktualisht raportohet në Regjistrin e Kredive dhe, më konkretisht, lidhur me raportimin e informacionit për kreditë në proces gjy-

Për Legjislacionin Fiskal

TVSH mbi shërbimet financiare

Në kuadër të ndryshimeve më të fundit në ligjin për TVSH-në dhe Udhëzuesin e ri përkatës, AAB filloi organizimin e takimeve midis drejtuesve financiarë të bankave që në muajin shkurt për të diskutuar për trajtimin kontabël të shërbimeve financiare që më përpara ishin të përjashtuara nga TVSH. Nevoja për sqarime u pasua nga takime dhe komunikime të shkruara midis AAB-së dhe drejtuesve financiarë të bankave, në njërën anë, dhe Zëvendës Ministrit të Financave, në anën tjetër, e, më tej, me Drejtorin e Politikave Fiskale në Ministri, veçanërisht lidhur me përjashtimin nga TVSH të shërbimeve financiare ndaj bankave të realizuara nga jo-rezidentët (të tilla si kartat, SWIFT, Reuters / Bloomberg, e-banking, etc).

Komunikimet vazhduan gjatë gjithë vitit dhe u kurorëzuan me një përgjigje me shkrim nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila saktëson se për shërbime të tilla, TVSH duhet aplikuar përmes mekanizmit të autofaturimit, por nuk jepet përgjigje për shërbime si Kartat Master /Visa /Amex, bankomatët apo online banking.

Për taksën mbi të ardhurat

Përfaqësuesit e bankave u mbledhën në gusht për të diskutuar një projekt ligj të ri "Për tatimin mbi të ardhurat" paraqitur nga Ministria e Financave përpara Këshillit të Taksave.

Ndryshimet kryesore shqetësuese të paraqitura në draft ishin njohja për qëllime tatimi e provigjioneve të humbjeve të kredive dhe fshirja e kredive të këqija, çka do ta rikthente situatën në njohjen e provigjioneve nga Banka e Shqipërisë dhe pamundësinë e fshirjes së kredive të këqija.

Pas mbledhjes, me vendim të Komitetit Ekzekutiv të AAB-së, Sekretariati i AAB krijoi një grup pune me drejtuesit financiarë të 5 bankave dhe 2 ekspertë të pavarur fiskalë me qëllim përgatitjen e një propozimi konkret, së bashku me relacionin shpjegues, për formulimin e neneve të ligjit që ndikimin më të madh do ta kenë mbi bankat dhe paraqitjen e tyre pranë Ministrisë së Financës.

Në takimin e Këshillit Tatimor, në nëntor, ku Ministria e Financave paraqiti ndryshimet legjislative për t'u përfshirë në paketën fiskale 2016.

Plani i Veprimit për Pakësimin e Kredive me Probleme

Në vijim të takimeve midis përfaqësuesve të bankave dhe kreut të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe përfaqësuesve të tjerë nga Banka e Shqipërisë, dhe, më pas, me Guvernatorin dhe Ministrin e Financave në muajt mars dhe prill për të diskutuar rreth masave të mundshme rregullatore dhe masave të tjera nga Banka e Shqipërisë dhe institucione të tjera, me qëllim pakësimin e kredive me probleme, AAB përgatiti një listë propozimesh për ndryshime në rregullore dhe ligje lidhur me këtë çështje. Në qer-

shor u krijua një grup pune ndërinstitucional në përputhje me Vendimin e përbashkët të Kryeministrit dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nën drejtimin e Zëvendës Ministrit të Ekonomisë. AAB ishte anëtare e këtij grupi pune së bashku me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet financiare ndërkombëtare si FMN, Banka Botërore dhe IFC.

Nga korriku në nëntor pati disa mbledhje të Grupit të Punës i cili doli me një Plan Veprimi për masat që duhen ndërmarrë lidhur

me ndryshimet në: Kodin e Procedurës Civile; Ligjin “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, ligjin “Për barrët siguroese”, ligjin “Për procedurat Tatimore”, rregulloret e Bankës së Shqipërisë si: “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”; trajtimin e kolateralit të rimarrë në pronësi, fshirjen e kredive të këqija, etj.

Në nëntor, Komiteti Ligjor i AAB-së shqyrtoi dhe përgatiti komente lidhur me projekt ndryshimet përgatitur nga Ministria e Drejtësisë në zbatim të Planit të veprimit në Kodin

e Procedurave Civile; ligjin për Shërbimin e Përmbaramit Gjyqësor Privat, ligjin për Regjistrimin e Pasurisë së Paluajtshme si edhe ndryshimet shtesë të propozuara në Kodin Civil. Të gjitha ndryshimet e mësipërme janë propozuar për të sqaruar sa më shumë nga nenet dhe dispozitat kontroversiale që përdoren në gjykata për të zvarritur proceset e ekzekutimit të detyrueshëm, me qëllim rregullimin e procesit të ekzekutimit dhe garantimin e një procesi huadhënieje më të sigurt e të kontrolluar përsa i takon kolateraleve.



EDUKIMI FINANCIAR

JAVA E PARASË

Këtë vit midis datave 9 dhe 13 mars u zhvilluan në mbarë vendin veprimtaritë për ndërgjegjësimin dhe edukimin financiar. AAB bashkëpunoi me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për organizimin e disa aktiviteteve edukuese mbi financat për fëmijë dhe të rinj. Kjo javë e marsit shënoi njëherazi Javën Evropiane të Parasë dhe Javën Globale të Parasë: Java Evropiane e Parasë është organizuar për herë të parë nga Federata Evropiane e Bankave (FEB), ndërsa Java Globale e Parasë është iniciuar për herë të parë nga Financat Ndërkombëtare për Fëmijët dhe të Rinjtë (Child & Youth Finance International - CYFI).

9 Mars - Aktiviteti i parë me të cilin filloi Java e Parasë, ishte një bisedë midis bankierëve dhe adoleshentëve (15-18 vjeç) rreth financimit, veçanërisht, rreth produkteve dhe aplikimeve bankare që mund të përdoren nga ata, të cilat u prezantuan nga z. Erion Maxhari nga Fibank, dhe z. Arjan Berberi nga Raiffeisen Bank. Aktiviteti u organizua në Mjediset e Qendrës Rinore në Tiranë.





10 Mars - Nxënësit e shkollës së mesme ekonomike në Tiranë vizituan ambientet e një dege të BKT-së. Qëllimi kryesor i vizitës ishte për t'u shpjeguar atyre se si funksionon një degë banke. Gjatë së njëjtës ditë, u organizuan dy leksione të hapura me Studentët e Klubit Ekonomik. Seminarët u mbajtën përkatësisht nga z. Elvin Meka, kryeredaktor i revistës Bankieri, i cili mbajti leksionin mbi "Normat e interesit bankar", dhe znj. Artiola Agalliu, Shefe e Departamentit të Riskut të Union Bank, e cila e njohu auditorin me temën "Kategoritë e Kredive, me fokus të kreditë me probleme".

11 & 12 Mars - Në bashkëpunim me Teatrin e Kukullave u organizuan shfaqja "Derrkuci Çufo mëson të kursejë", për fëmijët e moshës 7-9 vjeç nga shkolla të ndryshme të Tiranës. Rreth 200 fëmijë morën pjesë në këtë shfaqje që u shpjegon atyre rëndësinë e kursimit.



13 Mars - Në bashkëpunim me Universitetin Europian të Tiranës u organizua konkursi me "Nëse do të ishim bankierë". Fituesve iu shpërndanë karta debiti individuale nga Tirana Bank. Në fillim të javës, Sekretariati i AAB-së hodhi në faqen YouTube dhe Facebook një quiz financiar dhe "Kreditë Konsumatore". Fituesit morën si dhuratë nga një kopje të librit "Historik mbi Bankat në Shqipëri".



Video Informative

AAB hodhi në qarkullim serinë e videove me titull “Banka ime.” Ky projekt ka për qëllim të ofrojë detaje dhe informacion të thjeshtë rreth një sjelljeje të shëndoshë financiare për klientët e rinj dhe ekzistues të bankave. Projekti përfshin realizimin e videove me tema të ndryshme, kryesisht duke u fokusuar në produktet bankare që shiten me pakicë. Videot mund të gjenden në faqen e internetit dhe në faqet YouTube dhe Facebook të AAB-së. Gjatë vitit 2015 janë publikuar videot në vijim:


Kartat bankare

Metodat e pagesës

Kreditë hipotekore

Normat e interesit

Komisionet Bankare



Broshurë Informative

Me qëllim përmirësimin e transparencës dhe nivelit të informacionit që u jepet klientëve përpara lidhjes së kontratës për kredi konsumatore, me njërën nga bankat në Shqipëri, AAB, në konsultim me Zyrën për Mbrojtjen e Konsumatorit, botuan broshurë informative me titull “Kredia Konsumatore.” Kjo broshurë, së bashku me udhëzuesin për bankat tregtare, do t’u japë konsumatorëve informacionin e nevojshëm për të menaxhuar financat e tyre.



FORUME, SEMINARE DHE TRAJNIME

— Forume

Forumi i dytë për zbatimin e SWIFT në Shqipëri

5 maj 2015 – AAB organizoi Forumin e Dytë për Zbatimin e SWFIT-it në Shqipëri, me mbështetjen e SWIFT Austria. Prezantimet dhe diskutimet në forum u fokusuan në temat e evolucionit dhe trendet në zbatimin e rregulloreve për krimin financiar, praktikat më të mira për sigurimin e cilësisë, garantimin e sigurisë dhe efikasitetin e veprimeve kundër pastrimit të parave, sanksioneve dhe zbatimin e rregullave të njohjes së klientit (Know Your Customer – KYC). Veprimtaria u ndoq nga 40 përfaqësues të Departamenteve të Pagesave dhe Kundër Pastrimit të Parave të bankave anëtare, Bankës së Shqipërisë dhe të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave në Shqipëri.



Forumi i Parë i Auditorëve të Brendshëm në Shqipëri

18 qershor 2015 – AAB dhe Instituti i Auditorëve të Brendshëm organizoi Forumin e Parë të Auditorëve të Brendshëm, i cili u përqendrua në zhvillimin dhe situatën aktuale të profesionit të auditorit të brendshëm në sektorin bankar shqiptar. Ai u ndoq nga auditorët e brendshëm dhe drejtorët ekzekutivë /përfaqësuesit e nivelit të lartë drejtues të bankave në Shqipëri, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave, Bankës Qendrore të Kosovës, kompanive ndërkombëtare të konsulencës, si dhe institucioneve financiare dhe organizatave profesionale në Shqipëri dhe Kosovë.



Forumi i Katërt Kombëtar për Sigurinë Bankare

26 nëntor 2015 – AAB organizoi për të katërtin vit radhazi Forumin Kombëtar për Sigurinë Bankare, me pjesëmarrjen e disa institucioneve shtetërore, si Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE), Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave, si dhe kompanitë private, të cilat ofrojnë shërbime apo produkte të sektorit bankar në lidhje me sigurinë. Shoqata e Bankave të Kosovës ka qenë një partner aktiv në këtë veprimtari dhe paraqiti një pasqyrë të tendencave dhe zhvillimeve në vitet e fundit, në lidhje me dy sulmet fizike dhe kibernetike ndaj bankave në Kosovë.



— Seminare

Qartësimi i ndryshimeve në Legjislacionin Fiskal: 19, 20 janar dhe 24 shkurt

AAB organizoi dy seminare rreth legjislacionit të përditësuar fiskal, i cili hyri në fuqi në janar të vitit 2015. Seminarët u organizuan në bashkëpunim me organet tatimore dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Ato u ndoqën nga specialistët e departamenteve të burimeve njerëzore dhe specialistët e departamenteve të financave të bankave anëtare.



Seminar për “Përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin bankar”: 4 mars

Seminari u organizua nga AAB në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Përfaqësuesit e departamenteve të burimeve njerëzore të bankave që morën pjesë në seminar, u diskutuan probleme të ndryshme me të cilat përballet sistemi bankar në kuadrin e zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.



Seminar nga Deloitte rreth TVSH-së për bankat: 12 mars

Për shkak të ndikimit të madh të ligjit të ri për TVSH-në në industrinë bankare dhe interesit të madh të treguar nga bankat, Deloitte organizoi në ambientet e AAB një seminar të dedikuar për drejtuesit financiarë dhe kontabilistët e bankave anëtare. Ekspertët e Deloitte prezantuan dhe u diskutuan ndryshimet që ligji i ri dhe udhëzimi përkatës sjellin në punën e përditshme të bankave.



Seminar rajonal për një zbatim më të mirë të kuadrit rregullator kundër pastrimit të parave: 26 qershor

AAB në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave organizoi në Vlorë një seminar rajonal për punonjësit e bankave në jug të Shqipërisë. Seminari u drejtua nga z. Ndue Maluta, anëtar i Kryesisë së Komitetit të AAB për Përputhshmërinë dhe Drejtues i Grupit të Riskut në BKT, si dhe z. Agim Ismaili, i cili përfaqëson DPPPP. Seminari u ndoq nga 36 punonjës të degëve të bankave në Vlorë, Berat, Fier, Gjirokastrë dhe Lushnjë.



TRAJNIME



Tema	Data	Partner në trajnim/trajner	Grupi përfitues
Aftësitë drejtuese	24-25 Mars	Smart Banking Payment Systems Technologies	Menaxherët e nivelit mesëm
Aftësitë dhe Teknikat për Mbledhjen e Kredive	26-27 Mars	Smart Banking Payment Systems Technologies	Menaxherët e nivelit mesëm
Shkrimi i Raporteve të Auditit	26-27 Mars	Instituti Shqiptar i Audituesve të Brendshëm	Auditorët e brendshëm të Bankave
Menaxhimi Strategjik Burimeve Njerëzore	1-2 Prill	Instituti Austriak i Ekselencës	Menaxherët e nivelit të Burimeve Njerëzore
Ristrukturimi i Korporatave	21-22 Prill	Instituti Austriak i Ekselencës	Menaxherët e nivelit të lartë
Menaxhimi i riskut	23-24 Prill	Instituti Austriak i Ekselencës	Menaxherët e nivelit lartë
Risku operacional	17-18 Qershor	BACEE	Drejtorët, Menaxherët e nivelit të lartë, Auditorët Drejtuesit e Lartë
Sfidat dhe Praktikrat më të mira në Mbledhjen e Borxhit dhe Basel II/III	24 Qershor	PROFILE	Menaxherët e nivelit lartë
Menaxhimi i Cash-it dhe Pagesave	16-17 Shtator	SWIFT AUSTRIA	Përdoruesit dhe operacionet Swift
Zhvillimi i Produktit	21-22 Shtator	Smart Banking Payment Systems Technologies	Specialistët e nivelit lartës
Të drejtosh nga pozicioni ku gjendesh	21-22 Shtator	Qendrat Linkoln	Menaxherët, Drejtorët Departamenteve
Ekselencia në shitje	22-23 Shtator	Instituti Austriak i Ekselencës	Menaxherët e shitjeve

	Përshkrim i shkurtër	Nr. i pjesëmarrësve nga bankat
të	Drejtimi përkundër menaxhimit; Si të përmirësojmë aftësitë drejtuese, motivimin, treguesit përcaktues të sjelljes, etj.	10
të	Fokusimi te bazat e mbledhjes së kreditit dhe ekipet dinamike të mbledhjes, si dhe aspektet organizacionale për një mbledhje të efektshme.	10
ëm	Të ndihmohen audituesit për të kuptuar rëndësinë e dokumenteve informative bindës dhe shkrimin e tyre në mënyrë të qartë dhe koncize.	11
lartë	Të mësojmë të mendojmë çdo ditë në mënyrë krijuese në procesin e planifikimit të burimeve njerëzore.	10
	Vështrim i përgjithshëm mbi instrumentet bankare për financimin e korporatave, menaxhimin e ekspozimit të korporatave dhe falimentimit të tyre, metodat dhe teknikat e përdorura nga bankat për trajtimin e borxhit të sforcuar të korporatave.	10
të	Integrimi i menaxhimit të riskut të kredisë në organizimin e përgjithshëm të bankave dhe ciklin jetësor të kredisë, shoqëruar me një numër rastesh studimore për kompanitë prodhuese, tregtare dhe turistike.	8
të e prë,	Fushat kyçe për menaxhimin me cilësi të lartë të riskut, veçanërisht në analizën dhe vlerësimin e riskut, raportimin e riskut dhe paraqitjen e treguesve të riskut, si dhe menaxhimi në situatë ekspozimi madhor.	16
të	Strategjitë e Mbledhjes & Praktikave më të mira. Nga metoda empirike të mbledhjes bazuar te risku. Risku i kredisë, praktikave më të mira për zbatimin e projekteve.	9
	Pagesat dhe aftësitë, si dhe teknikat e menaxhimit të parasë fizike – përdorimi i mesazheve FIN.	12
të	Procesi Stage Gate për zhvillimin e produktit të ri; Faktorët kritikë për suksesin në nivel projekti; Impakti i klimës dhe kulturës së duhur për inovacionin dhe roli i drejtuesve të lartë; Strategjitë e ciklit të jetës së produktit.	6
të e	Të ndihmohen pjesëmarrësit të kuptojnë si udhëheqin dhe si mund t'i udhëheqin të tjerët më mirë në procesin e dhënies së kontributit për organizatën.	8
e	Përmirësimi i teknikave të shitjes, krijimi i aftësive drejtuese dhe forcimi i aftësive vendim-marrëse, motivuese, komunikuese dhe këshilluese.	11

Tema	Data	Partner në trajnim/trajner	Grupi përfitues
Kapja dhe parandalimi i mashtrimeve	1 - 2 October	Instituti Shqiptar i Audituesve të Brendshëm	Audituesit e brendshëm, ekzaminuesit e mashtrimeve, nëpunësit kundër mashtrimeve, nëpunësit e zbatimit të rregullores
Parandalimi i mashtrimeve	13 - 15 October	Shkolla e Biznesit VISA	Specialistët kundër mashtrimeve
Zyra e Operacioneve në Banka	21-23 October	ATTF Luxembourg	Personat që punojnë shërbimet financiare
Basel II dhe më tej	2 - 4 November	ATTF Luxembourg	Drejtuesit e lartë dhe të mesëm; nëpunësit e përfshirë në menaxhimin e riskut dhe në menaxhimin e aseteve dhe detyrimeve
Komunikimi në Biznes: Arti i të biseduarit	5 - 6 November	Qendrat Linkoln	Menaxherët e nivelit të mesëm
Negociatat win-win	12 - 13 November	Qendrat Linkoln	Kontribuuesit individualë, drejtuesit e nivelit të lartë, përgjegjësit e biznesit për negociatat
Udhëheqja strategjike dhe qeverisja e efektshme	23-24 November	Instituti Austriak i Ekselencës	Menaxherët e nivelit të lartë
Përdorimi i sistemit të vlerësimit me pikë në menaxhimin e rrezikut	24-25 November	Bankat Inteligjente Sistemet e Page-save Teknologjitë Bankare	Menaxherët e nivelit të mesëm
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	9-11 December	ATTF Luxembourg	Specialistët e lartë të burimeve njerëzore

	Përshkrim i shkurtër	Nr. i pjesëmarrësve nga bankat
n, meve, tri-imit	Të ndihmohen pjesëmarrësit të pasurojnë dijet e tyre mbi llojet e ndryshme të mashtrimit dhe njohja me të gjitha ndryshimet e bëra në kuadrin rregullator për mashtrimet.	20
	Të jepet një vështrim i thelluar në të gjitha instrumentet më të fundit, informacionin më të përditësuar dhe praktikatat më të mira që ekzistojnë si për ata që i përdorin edhe ata që i luftojnë me qëllim forcimin e luftës kundër mashtrimeve, pakësimin e humbjeve nga mashtrimet dhe rritjen e nivelit të fitimit në banka.	24
e në	Një përzierje e teorisë me praktikën duke u dhënë mundësi pjesëmarrësve të kryejnë ushtrime bazuar në situatat realiste që ndeshen nga stafi i zyrave mbështetëse.	17
in e min e e	Dhënia e njohurive të forta rreth aspekteve kyçe të evolucionit në Matjen e Kapitalit Rregullator sipas rregullave të reja të Baselit.	19
të	T'u jepen pjesëmarrësve aftësi për një komunikim më të efektshëm me klientët dhe lidhjet e biznesit.	8
ualë, lartë, ve	Vendosja e fokusit mbi konceptet e pranuar në shkallë të gjerë mbi negociatat si dhe taktikat për të zhvilluar negociatat të vështira.	9
të	Përdorimi i Indeksit të Parashikimit të Profilit të Sjelljes prej drejtuesit në vlerësimin e vetvetes për përcaktimin e stilit natyror të drejtimit dhe mënyrat e ndikimit të tjerët pa qenë në pozitë të drejtuesit.	13
të	Një vështrimi të përgjithshëm mbi sistemin e vlerësimit me pike në kreditim; automatizimin e proceseve vendimmarrëse të kredimit dhe mënyrën se si institucionet kryesore janë duke përdorur analizën për të arritur rezultate më të shpejta me qëllim kënaqësinë konsumatore	9
s	Rishikimi i koncepteve, kryerja e ushtrimeve të shumta praktike dhe diskutime me pjesëmarrësit lidhur me sfidat më të fundit që ndeshin në fushën e burimeve njerëzore.	17

VEPRIMTARI SHOQËRORE

Veprimtari me përfaqësues të medieve

Shtator - Në kuadrin e ndërtimit të urave të komunikimit me medianë në funksion të krijimit të një mjedisi të përshtatshëm dhe të forcimit të komunikimit efektiv, AAB organizoi një mëngjes pune ndërmjet anëtarëve të Bordit Drejtues dhe përfaqësuesve të medias. Bankierët dhe gazetarët ranë dakord se një komunikim më i mirë dhe efektiv midis dy palëve do të çonte në një informim më të mirë të publikut.

Tetor - AAB organizoi në Vlorë një aktivitet dy ditor të konceptuar si një udhëtim trajnimi me 13 gazetarë të fushës së ekonomisë, të cilët patën mundësinë të zgjeronin njohuritë e tyre rreth çështjeve financiare dhe bankare falë prezantimeve dhe diskutimeve me përfaqësues të BKT, FIBank, Tirana Bank dhe Procredit Bank. Dita e dytë e aktivitetit u pasua nga një udhëtim me anije në Sazan dhe Karaburun, gjatë të cilit u krijua një mjedis miqësor ku gazetarët dhe bankierët patën më tepër mundësi të shtjellonin çështje ekonomike dhe bankare.



Pritje mirëseardhje / lamtumire

Maj - u organizuan pritje mirëseardhjeje për Drejtorin e ri Ekzekutiv të Bankës NBG Shqipëri – z. Ioannis Agathos, të Tirana Bank – z. Dritan Mustafa, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë – z. Muhamed Prlja.

Tetor - U organizua një pritje lamtumire për nder të z. Luc Beiso, i cili u largua nga posti i Drejtorit Ekzekutiv të Crédit Agricole Banka Shqipëri dhe mirëseardhjeje në Shoqatë për Drejtorin e ri Ekzekutiv, z. Andi Ballta.



Darka e Fundvitit

Dhjetor – AAB organizoi Darkën e Fundvitit, në të cilën morën pjesë drejtorët dhe përfaqësuesit e bankave anëtare, të ftuar specialë nga Banka e Shqipërisë, si Guvernatori, Zëvendës Guvernatori, Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Drejtori i Kabinetit, Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe anëtarët e redaksisë së revistës Bankieri.



PUBLIKIME

Raporti i Përgjegjësisë Sociale të Korporatave 2014 – Bankat për Shoqërinë

AAB botoi për herë të parë një raport të titulluar “Raporti i Përgjegjësisë Sociale 2014 – Bankat për Shoqërinë”, i cili synon të bëjë të njohura disa nga kontributet në projektet shëndetësore, shoqërore, arsimore, mjedisore, kulturore dhe sportive të ndërmarra nga bankat përgjatë vitit 2014. Ky botim u promovua gjatë një ceremonie më 15 Qershor 2015, dhe që u ndoq nga personalitete të fushës së ekonomisë dhe sistemit bankar, politikës, bizneset si edhe nga përfaqësitë e huaja në Shqipëri.



Raporti Vjetor 2014

AAB botoi në qershor Raportin Vjetor 2014, i cili pasqyron zhvillimet kryesore dhe aktivitetet më të rëndësishme të Shoqatës përgjatë vitit 2014.

Numrat 14, 15, 16, dhe 17 të Revistës Bankieri

Sekretariati i AAB nxori në muajt janar, prill, korrik dhe tetor 2015, numrat e rinj të revistës Bankieri. Gjatë gjithë vitit, këto botime iu shpërndanë grupeve të synuara ndër banka, institucione shtetërore, organizata të huaja në Shqipëri dhe jashtë saj, medias dhe shoqatave të tjera bankare në rajon. Po ashtu, revista gjendet dhe mund të shkarkohet online në faqen e AAB-së si dhe në rrjetet sociale (LinkedIn, Face book, Twitter).

Statistika

AAB botoi në faqen e saj të dhënat e paudituar të tremujorit mbi treguesit kryesorë të sistemit bankar sipas standardeve të IFRS, si dhe të dhënat e përmuajshme të agreguara për të gjithë sistemin. Raportet tremujore shoqërohen edhe me deklaratat për shtyp.

Lajme Mujore

Sekretariati i AAB nxjerr një njoftim mujor me aktivitetet e AAB-së, e cila u shpërndahet bankierëve të nivelit drejtues dhe atij menaxherial.



BANKAT ANËTARE - FAKTE DHE SHIFRA

Banka	Struktura e Aksionarëve	Vendi i origjinës	Aktivet	Kreditë	Investime Letra me Vlerë të Qeverisë
 ALPHA BANK	Alpha Bank AE (100%)	Greqi	504,306	260,745	97,125
 AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	Tranzit Shpk (100%) - NCH Capital Group	Shqipëri-USA	192,481	72,536	41,041
 BANKA KOMBËTARE TREGTARE	Calik Finansal Hizmetler A.S. 100%	Turqi	2,501,426	840,256	1,020,183
 CREDINS bank	Individuals and ASC Union 58,42% B.F.S.E Holding BV 16,82% Other (less than 5% of shareholding)	Shqipëri Hollandë Shqipëri	1,043,448	628,029	138,967
 CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT E SHQIPËRIË	Al-Kharafi Group (100%)	Kuvajt	15,015	2,222	679
 FIBANK First Investment Bank	Fibank AD 100%	Bullgari	123,397	45,149	53,448
 INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK rendesi kanë vlerat	ICB Financial Group Holding (100%)	Zvicër	68,153	29,926	29,926
 INTESA SANPAOLO BANK Albania	Intesa Sanpaolo S.p.A. (100%)	Itali	1,030,211	327,797	335,620
 NBG Bank	National Bank of Greece S.A. (100%)	Greqi	284,026	214,323	37,878
 ProCredit Bank	ProCredit Holding AG & Co. KGaA 100%	Gjermani	254,714	163,379	17,380
 RAIFFEISEN BANK	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH - 100%	Austri	2,110,711	832,464	526,236
 SOCIETE GENERALE ALBANIA	Societe Generale - 88,64% Minority Shareholders - 11,36%	Francë Shqipëri	533,784	299,603	145,654
 TIRANA BANK	Piraeus Bank (98,83%) Ioannis Tzivelis (1,17%)	Greqi	593,399	269,549	148,802
 UNIONBANK	Unioni Financiar Tirane (UFT) Sh.p.k (86,65%) European Bank for Reconstruction and Development (EBRD) 9,87% Individuals (3,48%)	UK Shqipëri	278,017	121,414	99,968
 BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRIË UNITED BANK OF ALBANIA	Islamic Development Bank (86,7%) Ithmaar Bank (4,63%) Dallah Albaraka Holding Co. (2,32%) Business Focus SDN BHD (1,47%) Saudi Brother Commercial Co. (0,58%) Individuals (4,31%)	Arabia Saudite Bahrain Bahrain Malajzi Arabia Saudite Arabia Saudite	45,632	16,847	2,175
 VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA	VENETO BANCA S.P.A. 100%	Itali	190,031	116,100	4,144

Shoqata Shqiptare e Bankave

Kapitalet e veta	Depozita	Fitimi neto	Nr. degësh	Nr. punonjësish	Nr. ATM	Nr. karta të lëshuara	Karta Debiti	Karta Krediti	Nr. POS	E-banking	Mobile Banking	E-commerce
83,819	401,546	(12,008)	40	427	54	80,534	72,619	7,915	1,310	PO	PO	JO
15,155	166,434	(19,392)	19	252	30	11,375	10,675	700	-	PO	JO	JO
268,997	2,036,619	45,691	89	1,285	148	279,951	241,539	38,412	3,748	PO	PO	PO
86,697	899,849	958	56	739	60	102,821	99,188	3,633	530	PO	PO	PO
9,602	4,299	384	2	28	-	-	-	-	-	JO	JO	JO
13,333	107,148	1,828	9	126	30	31,076	27,476	3,600	-	PO	JO	JO
10,928	50,364	(787)	6	92	6	2,272	2,272	NO	-	JO	JO	JO
141,554	865,691	16,063	32	567	49	80,944	80,944	-	561	PO	PO	JO
59,813	193,123	702	27	293	36	25,930	25,467	463	-	JO	JO	JO
36,472	207,900	1,122	22	309	59	37,886	37,055	831	457	PO	JO	JO
215,538	1,799,098	12,860	89	1,406	194	217,807	194,191	23,616	1,347	PO	PO	PO
61,769	433,396	1,777	39	395	60	38,001	38,001	-	-	PO	PO	JO
108,973	464,357	(24,153)	39	422	71	90,506	86,509	4,037	245	PO	PO	JO
25,418	230,320	2,722	29	349	39	30,206	27,783	2,423	-	PO	PO	JO
10,917	34,235	215	6	74	-	-	-	-	-	JO	JO	JO
22,080	155,424	(7,566)	15	130	16	12,523	12,137	386	112	PO	JO	JO

Të dhënat e audituara sipas IFRS, në 31.12.2015 (1 EUR = 137.28 ALL)

PASQYRAT FINANCIARE TË AAB-SË

PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2015

PASQYRAT E POZICIONIT FINANCIAR

	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
<u>AKTIVET</u>			
Aktive afatshkurtra			
Arka dhe Banka	4	9,325,817	14,571,268
Shpenzime të parapaguara	5	1,246,430	1,065,692
Totali i Aktiveve Afatshkurtra		10,572,247	15,636,960
Aktivitet Afatgjata			
Aktivitet e qendrueshme, neto	6	723,870	810,693
Totali i Aktiveve Afatgjata		723,870	810,693
TOTALI I AKTIVEVE		11,296,117	16,447,653
<u>DETYRIMET</u>			
Llogari të pagueshme	7	934,462	626,645
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		934,462	626,645
Aktivitet Neto		10,361,655	15,821,008
TOTALI I DETYRIMEVE		11,296,117	16,447,653

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

STATEMENT OF INCOME AND EXPENDITURE

	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
<u>TË ARDHURAT</u>	8		
Kuotat e anëtarësisë		33,000,000	33,000,000
Të ardhura për trajnime		4,032,055	876,406
Interesat nga llogaritë rrjedhëse		7,885	11,398
Totali i Ardhurave		37,039,940	33,887,804
 <u>SHPENZIMET</u>			
Amortizimi	6	(170,238)	(201,379)
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve të qendrueshme	6	(10,851)	-
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrimit	9	(29,506,273)	(25,343,844)
Shpenzime për trajnime	10	(4,020,423)	(988,207)
Pagesa për Donacione	11	(8,758,141)	-
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit	13	(33,367)	313
Totali i Shpenzimeve		(42,499,293)	(26,533,117)
 Teprica/deficit i të Ardhurave ndaj shpenzimeve		(5,459,353)	7,354,686
 Aktivet Neto në fillim të vitit		15,821,008	8,466,322
 Aktivet Neto në fund të vitit		10,361,655	15,821,008

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

STATEMENT OF CASH FLOW

	Shënime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
<i>Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytëzimit</i>			
Teprica/deficiti të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		(5,459,353)	7,354,686
Rregullime për:			
Amortizim	6	170,238	201,379
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve të qendrueshme	6	10,851	-
Të ardhura nga interesa bankare (llogari rrjedhëse)		(7,884)	(11,398)
Pagesa për shpenzimet e parapaguara	5	(180,740)	(86,689)
Llogari të arkëtueshme		-	22,394
Pagesa për llogaritë e pagueshme	7	307,817	194,220
Interesat nga llogaritë rrjedhëse		7,884	11,398
Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit		(5,151,187)	7,685,990
<i>Fluksi monetary nga veprimtaritë investuese</i>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	6	(94,265)	(157,560)
Fluksi monetary nga veprimtaritë investuese		(94,265)	(157,560)
RRITJA/RENIA NETO E MJETEVE MONETARE		(5,245,452)	7,528,430
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	4	14,571,268	7,042,838
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	4	9,325,816	14,571,268

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar në datë 31.03.2016 dhe nënshkruar nga:



Endrita XHAFFERAJ
Sekretare e Përgjithshme
Shoqata Shqiptare e Bankave



Elvira TARTARI
Drejtoresh e Departamentit të Financës
Banka ProCredit Shqipëri

1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9, Ap.3, Tiranë, Shqipëri.

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përpiqet të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 16 anëtarë, mbi baza vullnetare: Alpha Bank Shqipëri, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Societe General Albania, Banka Credins, Banka e Kreditit të Shqipërisë, Banka e Parë e Investimeve, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka Intesa SanPaolo Shqipëri, Veneto Banka, Banka NBG Shqipëri, Banka ProCredit, Raiffesien Bank Shqipëri, Tirana Bank, Banka Union, dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

2. Baza e Përgatitjes

Librat dhe regjistrimet kontabël të AAB mbahen sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

3.1 Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat regjistrohen kur realizohen dhe shpenzimet kur ndodhin.

3.2 Aktivitetet e Qëndrueshme

Aktivitetet e qëndrueshme mbahen me kosto, minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi kryhet sipas metodës së vlerës së mbetur, duke shpërndarë koston e pasurisë dhe pajisjeve, përgjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit të tyre. Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes, me normat respektive prej:

	Në %
Mobiljet	20
Pajisjet elektronike	25

3.3 Konvertimi nga Monedha e Huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un (ALL). Të gjithë kontributet dhe pjesa dërrmuese e shpenzimeve janë në Lek (ALL). Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së transaksionit.

3.4 Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqëri jo fitimprurëse dhe si e tillë është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore, dhe taksave vendore.

4. Arka dhe Banka

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

Në LEK	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Arka	25,038	29,546
Banka	9,300,779	14,541,722
Totali	9,325,817	14,571,268

Banka përbëhet nga sa më poshtë:

Në LEK	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Llogari në LEK pranë BKT	7,664,239	11,867,421
Llogari në LEK pranë Union Bank	1,124,321	1,585,337
Llogari në LEK pranë Veneto Bank	469,816	771,546
Llogari në EUR pranë BKT	42,403	317,418
Totali	9,300,779	14,541,722

5. Shpenzime të Parapaguara

Shpenzimet e parapaguara përbëhen kryesisht nga: pagesat e anëtarësimit të AAB pranë BACEE për shumën 604,240 Lekë, që i korrespondon periudhës nga Janari në Korrik 2016; parapagim i një fature udhëtimi dhe akomodimi kryer në Janar 2016; parapagim për kontrata një vjeçare për mirëmbajtje dhe hostim internet dhe domain-esh (si për faqen zyrtare të internetit të Shoqatës, ashtu edhe për faqen e ankandeve), si dhe parapagim i sigurimit shëndetësor pranë SIGAL për punonjësit e Shoqatës për 196,630 Lekë, si më poshtë:

Në LEK	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Kuotë Antaresimi e parapaguar BACEE	604,760	604,240
Parapagim udhëtimi dhe akomodimi	103,386	
Abonim ABCOM (internet)	9,785	11,060
Hostim / Mirëmbajtje Domain	51,710	23,232
Sigurim Shëndetsor SIGAL UNIQA GROUP	196,630	147,000
Garanci për Qira	280,160	280,160
Totali	1,246,430	1,065,692

6. Aktivet e Qëndrueshme

Aktivet e Qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

Në LEK	Mobilje / Orendi	Pajisje Kompjuterike	Totali
<i>Kosto</i>			
Në 31 Dhjetor 2014	1,993,958	1,161,916	3,155,874
Shtesat gjatë vitit 2015	66,980	27,285	94,265
Pakësimi gjatë vitit 2015	(107,013)	(15,980)	(122,993)
Në 31 Dhjetor 2015	1,953,925	1,173,221	3,127,146
<i>Amortizimi i Akumuluar</i>			
Në 31 Dhjetor 2014	1,484,252	860,928	2,345,180
Amortizimi gjatë vitit 2015	91,054	79,184	170,238
Pakësimi gjatë vitit 2015	(97,595)	(14,547)	(112,142)
Në 31 Dhjetor 2015	1,477,711	925,565	2,403,276
<i>Vlera Neto e Librit</i>			
Në 31 Dhjetor 2014	509,705	300,988	810,693
Në 31 Dhjetor 2015	476,214	247,656	723,870

7. Llogari të Pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga sa vijon:

Në LEK	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Kuotë Antarësimi e papaguar EBF	411,840	
Detyrim për tatim mbi të ardhurat	227,628	236,135
Detyrim për Sigurime Shoqërore e Shëndetsore	171,680	146,538
Pagesa utilitetesh	68,068	50,127
Detyrim për tatimin në burim	37,499	-
Fatura të pambërritura (energji, ujë)	17,747	193,845
Total	934,462	626,645

8. Të Ardhurat

Me Vendim Asambleje N.r 6, datë 31.05.2011, bankat anëtare të paguajnë shuma të ndryshme, në proporcion me përqindjen që zënë asetet e tyre në totalin e asetëve të sistemit bankar (kuotë proporcionale), me një vlerë minimale për kuotat prej 1.000.000 Lek.

Të ardhurat nga tarifat e trajnimit përbëhet nga tarifat e marra nga bankat anëtare për kurset e trajnimit të organizuara nga AAB për punonjësit e bankave. Të gjitha të ardhurat e bëra nga trajnimi shkojnë për shpenzimet e nevojshme për organizimin e këtyre trajnimeve.

9. Shpenzimet e përgjithshme dhe të Administrimit

Shpenzimet e përgjithshme dhe të Administrimit në 2015 dhe 2014 përbëhen nga sa vijon:

Në LEK	2015	2014
Shpenzime personeli	11,460,953	11,357,540
Shpenzime të tjera të administrimit	18,045,320	13,986,304
Totali	29,506,273	25,343,844

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë:

Në LEK	2015	2014
Paga dhe Shpërblime	9,852,053	9,752,665
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,068,640	1,015,675
Sigurim shëndetësor SIGAL	540,260	589,200
Totali	11,460,953	11,357,540

Shpenzimet e tjera të administrimit paraqiten si më poshtë:

Në LEK	2015	2014
Reklama dhe Publikime	5,064,957	3,788,968
Shërbime utilitare	4,204,361	4,682,475
Shpenzime organizative	3,315,462	1,966,437
Shërbime konsulence	1,938,247	-
Shpenzime zyre	1,757,302	1,664,255
Kuota antarësimi	1,679,200	1,393,338
Komisione dhe tarifa bankare	75,671	60,995
Taksa vendore	10,120	10,120
Shpenzime për zyrat e reja	-	419,716
Totali	18,045,320	13,986,304

10. Shpenzime për organizimin e trajnimeve

Shpenzimet e bëra nga AAB, për organizimin i trajnimeve për punonjësit e bankave gjatë vitit 2015 arritën në shumën 4,020,423 lekë, dhe përbëhen nga tarifat e lektorëve dhe shpenzimet për udhëtimin dhe akomodimin e tyre; mjediset ku zhvillohet trajnimi shpenzimet catering; shpenzimet për printimin e materialit të trajnimit, etj.. Të gjitha këto shpenzime janë mbuluar nga tarifat e trajnimit të mbledhura nga bankat anëtare.

11. Donacione dhe Kontribute

Gjatë vitit 2015, ka patur 2 shpenzime të konsiderueshme të cilat nuk ishin parashikuar, si më poshtë:

Në LEK	2015	2014
Kontribut për zonat e përmytura	6,000,000	-
Mbështetje me publicitet për fushatën e Qeverisë anti-informalitet	2,758,141	-
Totali	8,758,141	

Në të dy rastet, ndërmarrja e këtyre shpenzimeve nga AAB është bërë me miratimin e Asamblesë së Anëtarëve.

12. Humbja nga kursi i këmbimit

Nga diferencat në kurset e këmbimit, gjatë vitit 2015 është shënuar humbje prej 33,367 Lekësh.

